
e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur ne vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

IMPLEMENTIMI I SMART SOLUTION LORAWAN NË INFRASTRUKTURËN NAFTËNXJERRËSE TË ALBPETROL SH.A PËR PERIUDHË 2 VJEÇARE

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Shoqëria shtetërore e naftës në Shqipëri “Albpetrol” Sh.A

1.2. Historiku

“Albpetrol” Sh.A është një shoqëri aksionere, e krijuar me Vendimin Nr. 21158, datë 08.03.1999, dhe vepron në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar. Aktiviteti kryesor i “Albpetrol” përfshin kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, duke mbuluar të gjithë ciklin e punimeve sizmike, gjeologjike, mekanike dhe gjeofizike, si dhe kërkimin, nxjerrjen dhe tregtimin e naftës bruto brenda dhe jashtë Shqipërisë, në përputhje me Ligjin Nr. 7746, datë 28.08.1993, të ndryshuar.

Veprimtaria e shoqërisë shtrihet gjithashtu në furnizimin me energji elektrike për klientët e kualifikuar dhe tregtimin e energjisë elektrike. Ajo përfshin gjithashtu hapjen e aktiviteteve të reja dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit, si dhe shpërndarjen e gazit natyror. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është monitorimi i Marrëveshjeve Hidrokarbure të lidhura me kompanitë koncesionare si dhe është i pajisur me leje mjedisore për aktivitetet që ndikojnë në mjedis, përfshirë vendburimet e naftës në Kuçovë, Patos-Marinëz, Qendrën Mekanike në Kuçovë, Gorisht-Kocul, Amonicë, si dhe vendburimet e gazit në Divjakë-Lushnje, Frakull-Fier, Povelçë-Fier dhe Finiq-Sarandë. Gjithashtu, ajo administron rrjetin e transmetimit të produkteve të naftës dhe gazit, vendburimin e rërës bituminoze në Kasnicë-Fier dhe Uzinat Mekanike në Kuçovë dhe Patos.

Realizimi i qëllimeve të veprimtarisë së shoqërisë realizohet përmes shfrytëzimit dhe zhvillimit të zonave ekzistuese naftëmbajtëse dhe gazmbajtëse në vend, kërkimeve të reja dhe zhvillimit të blloqeve nën administrim, si dhe shfrytëzimit të rërave bituminoze. Praktikat dhe atributet e ish-APC-së Tiranë, që lidhen me kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, i janë transferuar shoqërisë “Albpetrol” Sh.A që nga data 01.04.2003.

“Albpetrol” Sh.A tregon kujdes dhe angazhim të madh në trajtimin e çështjeve mjedisore, duke bashkëpunuar dhe lidhur kontrata të vazhdueshme me studio të specializuara dhe të pavarura për trajtimin e ndotjeve. Këto përfshijnë monitorimin dhe trajtimin e shkarkimeve të gazta, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, si dhe nivelit të zhurmave. Gjithashtu, shoqëria monitoron dekantimet, të cilat përbëjnë një nga burimet më të mëdha të ndotjes së ajrit, tokës dhe ujërave.

1.3. Situata Aktuale në Sektor

Infrastruktura inteligjente për monitorimin e të dhënave të Qendrave të Prodhimit të Naftës (QPN) do të zbatohet në disa sektorë të "Albpetrol" Sh.A. Sektorët e naftë-nxjerrjes dhe gaz-nxjerrjes organizohen si më poshtë:

Qendrat e Prodhimit të Naftës (QPN) të Albpetrol Sh.A, e zhvillojnë aktivitetin e tyre në tre qendrave kryesore: (1) QPN Fier, (2) QPN Kuçovë dhe (3) QPN Gorisht, të cilat mbulojnë vendburimet e tyre përkatëse. Çdo qendër ka pika dekantimi, ku përpunohet nafta e nxjerrë nga vendburimet që administrohen prej saj. Për qëllime administrimi dhe menaxhimi gjeografik, këto qendra ndahen në sektorë, ndërsa sektoret ndahen më tej në grupe. Çdo grup përbëhet nga disa puse. Albpetrol përdor dy lloje pusesh: (1) puse me depo dhe (2) puse pa depo, ku shumica e puseve i përkasin llojit të dytë. Nafta e nxjerrë nga këto puse grumbullohet në depon e grupit, e cila më pas transportohet drejt pikave të dekantimit. Procesi i dekantimit konsiston në përpunimin e fluidit për të prodhuar naftë bruto, e cila më pas shitet nga kompania. Dekantimi kryhet në nivel qendre, dhe çdo qendër mund të ketë një ose më shumë pika dekantimi. Raportimi i të dhënave nga qendrat bëhet në nivel grupi dhe sektori.

Qendra e Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit (QASHNG) është sektori që pranon dhe magazinon naftën bruto të prodhuar nga tre qendrat e prodhimit. Kjo qendër është përgjegjëse për procesin e depozitimit të naftës në magazinat fiskale dhe për shitjen e saj. Ekzistojnë dy metoda të transportimit të naftës drejt QASHNG: (1) përmes tubacioneve nga pikat e dekantimit dhe (2) përmes transportit me cisterna.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Synimi i këtij projekti është implemtimi i infrastrukturës inteligjente për komunikimin dhe transmetimin e të dhënave në distanca të gjata, duke përdorur sensorë me konsum të ulët energjie (LPWAN). Ky sistem inteligjent do të funksionojë në brezat e frekuencave të pa licencuara, siç janë brezat ISM (Industriale, Shkencore dhe Mjekësore), dhe do të mbështetet në teknologjitë e Internetit të Gjërave (IoT), duke mundësuar monitorimin në kohë reale të gjendjes së naftës ne depozitat e grupeve dhe sektorëve si dhe monitorimin e orëve te punës se puseve.

Disa nga nën-objektivat që duhen realizuar por pa u kufizuar në to, përfshijnë:

- Implementimi i një sistemi inteligjent komunikimi me valë (LoRaWAN) për transmetimin e të dhënave në distanca deri në 15 km në zonat rurale, duke përdorur sensorë që dërgojnë të dhëna me konsum të ulët energjie dhe që mundësojnë komunikim të dyanshëm ndërmjet sensorëve dhe stacioneve bazë, me qëllim sigurimin e transmetimit të besueshëm të të dhënave nga terreni në qendrën operative.
- Sistemi duhet të përfshijë instalimin dhe konfigurimin e sensorëve në pusët dhe rezervuarët e naftës të Qendrave të Prodhimit të Naftës si dhe për të siguruar një nivel të lartë sigurie, sistemi duhet të përdorë algoritme të enkriptimit AES me 128-bit, për të garantuar kriptimin nga skaji në skaj, duke përmbushur kërkesat e rrjeteve të naftës.
- Pajisja duhet të integrohet lehtësisht me platformën e aplikacioneve IoT përmes driverave të pajisjes dhe konektorëve si dhe të mundësojë integrim me platformat Cloud (si Azure IoT, AWS IoT, Cumulocity).

-
- Sistemi duhet të ofrojë fleksibilitet të plotë në lidhje me modelin e implementimit (SaaS ose On Premise), llojin e Gateway-t dhe brezat ISM për të shmangur çdo kosto shtesë, dhe duhet të jetë i integrueshëm me serverin e aplikacionit.
 - Implementimi i sistemit inteligjent me valë (LoRaWAN) duhet të realizohet në brezat ISM pa kosto shtesë (EU 868, AS 923, US 915 MHz), për të lejuar çdo ofrues shërbimi të Autoritetit Kontraktor të vendosë dhe operojë në rrjet pa pasur nevojë për licencim të frekuencave.
 - Platforma smart e sistemit duhet të mbledhë të dhënat nga sensorët dhe matësat inteligjentë, dhe këto të dhëna duhet të ofrojnë rekomandime për optimizimin e menaxhimit të shërbimeve.
 - Të gjitha aktivitetet që do të kryhen nga sistemi inteligjent me valë, duhet të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë teknike.

2.2. Qëllimi

Qëllimi(et) i kësaj kontrate është/janë si më poshtë:

1. Qëllimi i realizimit të këtij projekti është përmirësimi i monitorimit të nivelit të naftës në depozita dhe eliminimi i disa proceseve manuale që shkaktjnë vonesa dhe gabime në përllogaritje. Kjo përfshin implementimin e një sistemi inteligjent që mundëson monitorim në kohë reale të nivelit të naftës, duke përmirësuar gjithashtu monitorimin e kohës së punës së puseve, për të shmangur humbjet në prodhim dhe vonesat në mirëmbajtje.
2. Një tjetër qëllim është përmirësimi i parashikimeve të furnizimit dhe kërkesës, si dhe optimizimi i menaxhimit të gjëndjes në sektorin e shitjes së naftës.
3. Zgjidhja e propozuar përfshin një arkitekturë inteligjente me sensorë, ku përfshihen serveri i rrjetit, antenat LoRaWAN, sensorët inteligjentë për monitorimin e nivelit dhe ato të menaxhimit të energjisë, si aplikacioni inteligjent për vizualizimin dhe analizimin e të dhënave. Përdorimi i teknologjisë LoRaWAN siguron transmetim të besueshëm të të dhënave në distanca deri në 15 km në zonat rurale, duke përdorur energji të reduktuar dhe ofruar siguri të lartë të të dhënave përmes enkriptimit AES me 128-bit.
4. Projekti gjithashtu synon të ofrojë fleksibilitet të plotë në modelin e implementimit, duke lejuar përdorimin e sistemit si SaaS ose On-Premise, me integrim të lehtë me platformat IoT përmes API-ve të standardizuara.
5. Pajisjet/hardware të infrastrukturës inteligjente të monitorimit, duhet të plotësojnë specifikimet teknike për mbulim të gjerë, rezistencë ndaj kushteve ekstreme mjedisore dhe mbrojtje të nivelit IP67 për antenat dhe IP68 për sensorët. Sistemi duhet të ofrojë fleksibilitet në modelin e implementimit, duke lejuar zgjedhjen mes opsioneve SaaS dhe On-Premise, si dhe përdorimin e frekuencave ISM pa kosto shtesë, duke lejuar një funksionim pa nevojë për licencim të frekuencave.
6. Projekti synon të përmirësojë efikasitetin operativ, të rrisë sigurinë dhe të mbështesë vendimmarrjen strategjike, duke siguruar të dhëna të sakta dhe në kohë reale për monitorimin dhe menaxhimin e naftës në të gjitha sektorët e përfshira.

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Rezultatet që duhet të arrijë Operatori Ekonomik gjatë kësaj kontrate rënditen në vijim:

- Instalimin dhe konfigurimin e serveri të rrjetit;
- Instalimin dhe konfigurimin e sensorve të vëllimit për matjen e nivelit të fluidit në depozitat në sektor ose grupe;
- Instalimi dhe konfigurimi i sensorëve të energjisë;
- Instalimin dhe konfigurimin e platformës smart për monitorimin e nivelit të naftës në depozita si dhe monitorimin e punës së puseve;
- Instalimi dhe rregullimi i rrjetit LoRaWAN (duke përfshirë antenat) për të siguruar mbulimin e plotë të zonës ku do të vendosen sensorët;

- Konfigurimi i hapësirave të ruajtjes, konfigurimi i rrjetit, virtualizimit dhe komponentët e tjerë thelbësorë;
- Konfigurimi i kontrollit të aksesit të bazuar në role (RBAC) dhe politikat e sigurisë;
- Testimi i infrastrukturës së implementuar bazuar në planin e dakordësuar të testimeve;
- Përgatitja e dokumentacionit mbi konfigurimet e kryera;
- Trajnimi për përdorimin e platformës inteligjente;
- Mirëmbajtja 24- mujore e sistemit inteligjent të monitorimit (*pajisjet dhe aplikacionin*);

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

Disa nga supozimet e projektit janë:

Gjatë vendosjes dhe konfigurimit të antenave dhe pajisjeve, mund të hasen vështirësi në sigurimin e mbulimit të plotë të zonës ku do të instalohen sensorët, për shkak të terrenit sfidues ose distancave të mëdha midis vendburimeve. Këto faktorë mund të ndikojnë në funksionimin efikas të sistemit dhe kërkojnë planifikim të kujdesshëm për të siguruar mbulim të qëndrueshëm. Sfidat teknike gjithashtu mund të paraqiten gjatë integritetit të sistemit të ri me platformat ekzistuese të IoT, veçanërisht në lidhje me konfigurimin e saktë të API-ve dhe protokolleve të komunikimit. Kjo mund të kërkojë ndërhyrje të mëtejshme për të siguruar që sistemi funksionon pa probleme dhe është i përshtatshëm me mjedisin e tanishëm teknologjik.

Gjatë instalimit të sensorëve për matjen e volumit dhe energjisë në pusët dhe rezervuarët e naftës, mund të hasen vështirësi për shkak të kushteve të vështira mjedisore ose infrastrukturës së kufizuar në zonat rurale. Këto kufizime mund të ndikojnë në efikasitetin dhe saktësinë e sensorëve, duke kërkuar masa të veçanta për instalim. Në fazën e testimit të infrastrukturës dhe platformës, mund të jenë të nevojshme rregullime shitesë për të siguruar performancë optimale dhe për të garantuar integritetin e plotë me komponentët cloud dhe on-premise. Kjo mund të përfshijë modifikime të mëtejshme për të optimizuar sistemin dhe për të zgjidhur problemet e paraqitura gjatë testimeve fillestare.

Kontraktori mund të përballet me nevojën për mirëmbajtje të vazhdueshme të sistemit për të siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe për të adresuar çdo problem teknik që mund të shfaqet gjatë periudhës 24-mujore të mbikëqyrjes. Kjo mirëmbajtje është thelbësore për të garantuar që sistemi të operojë në mënyrë të besueshme gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes. Gjatë konfigurimit të virtualizimit dhe rrjetëzimit hibrid, për lidhjen e sistemit on-premise me cloud, mund të shfaqen vështirësi në sigurimin e lidhjes së pandërprerë dhe menaxhimin e sigurisë. Kjo përfshin adresimin e çështjeve të sigurisë dhe besueshmërisë së të dhënave gjatë komunikimit midis sistemeve.

Në implementimin e politikave të sigurisë, veçanërisht për mbrojtjen e të dhënave dhe analizimin e log-eve, mund të ndodhin sfida në optimizimin e masave të sigurisë. Kjo është thelbësore për të garantuar integritetin dhe ndjeshmërinë e të dhënave, duke marrë parasysh kërkesat e larta të sigurisë dhe mbrojtjes së informacionit.

3.2. Rrisqet

Disa nga risqet që mund të ndikojnë në mbarëvatjen e projektit janë:

- Mund të ndodhin probleme gjatë hartimit dhe planifikimit fillestar të projektit;
- Integrimi i sensorëve dhe pajisjeve me infrastrukturën e tanishme mund të përballet me problematika, sidomos për mbulimin e plotë të fushave me sinjal të qëndrueshëm;
- Transmetimi i të dhënave në distanca të gjata mund të ndikohet nga kushtet mjedisore apo pengesat fizike, duke sjellë vonesa ose humbje të të dhënave;
- Përdorimi i sensorëve në kushte ekstreme, për shembull në temperaturë të lartë ose lagështi, mund të sjellë dëmtime apo prishje të pajisjeve;
- Edhe pse sistemi aktualisht nuk varet nga frekuencat e licencuara, mund të ketë ndryshime në rregullimet ligjore që të kërkojnë licencime të reja në të ardhmen;
- Mund të ketë kosto shtesë për mirëmbajtje, ndryshime në teknologji, apo nevoja për përditësime të pajisjeve, që mund të ndikojnë buxhetin e projektit;
- Koordinimi i dobët midis ekipeve të ndryshme dhe grupeve të interesit mund të ndikojë negativisht në kohën e implementimit të projektit.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Ky projekt bazohet në aktet ligjore si në vijim:

- Ligji Nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”.
- Ligjin Nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar
- Ligji Nr. 10 325, datë 23.9.2010 “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”
- Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7746, datë 28.07.1993, “Për Hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin transportimin dhe tregtimin e naftës dhe gazit natyror dhe nën produkteve të tyre”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji Nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar.
- Vendimi Nr. 945, Datë 02.11.2012, “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”, të ndryshuar.
- Vendimi Nr. 491, datë 19.07.2017, “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës,të gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- Vendimi Nr. 279, datë 12.4.2012, “Për miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.07.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë) dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit (sot shoqëria “Albpetrol”, sh.a.)”, i ndryshuar;
- Vendimi Nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor);

4.1.1.Përshkrimi i detyrës

a. Vlerësimi Fillestar dhe Planifikimi:

- *Operatori Ekonomik do të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës të infrastrukturës ekzistuese dhe Qendrave të Prodhimit të Naftës (QPN), për të përcaktuar përputhshmërinë e saj me infrastrukturen e re objekt kontrate.*
- *Një plan i detajuar i zbatimit, duke përfshirë afatet kohore dhe pikat kryesore, do të sigurohet nga Operatori Ekonomik.*

b. Furnizimi dhe instalimi i harduerëve dhe softuerëve:

- *Operatori Ekonomik do të duhet të furnizojë, instalojë dhe konfigurojë serverin e rrjetit për të mbështetur infrastrukturën e nevojshme për të menaxhuar të dhënat dhe komunikimet e sistemit.*
- *Serveri duhet të konfigurohet dhe optimizohet për të mbështetur rrjetëzimin dhe integrimin me sensorët dhe pajisjet inteligjente, duke siguruar kriteret e kërkuara të përputhshmërisë.*
- *Operatori Ekonomik do të furnizojë, instalojë dhe konfigurojë sensorët e vëllimit për matjen e nivelit të fluidit në depozita në vendburimeve të përzgjedhura të naftës, si do të duhet të instalojë dhe konfigurojë sensorët e energjisë për menaxhimin e energjisë në pusët e përzgjedhura në këto vendburime.*
- *Sensorët duhet të instalohen në mënyrë të saktë dhe të komunikojnë në mënyrë efektive me sistemin për monitorim të vazhdueshëm.*
- *Operatori Ekonomik do të duhet të furnizojë, instalojë dhe konfigurojë rrjetin LoRaWAN, përfshirë antenat, për të siguruar mbulimin e plotë të zonës ku do të vendosen sensorët.*
- *Operatori Ekonomik do të duhet të furnizojë, instalojë dhe konfigurojë platformën inteligjente (smart) për monitorimin e nivelit të naftës në depozita dhe monitorimin e punës së puseve, duke siguruar kriteret e kërkuara të përputhshmërisë.*

c. Siguria dhe Pajtueshmëria:

- *Operatori Ekonomik duhet të zbatojë masat e sigurisë, duke përfshirë kontrollet e aksesit bazuar në role (RBAC) dhe pajtueshmërinë me rregulloret përkatëse të sigurisë, për të mbrojtur të dhënat e ndjeshme.*
- *O.E duhet të asistojë Autoritetin Kontraktor në krijimin e një strategjie gjithë përfshirëse back-up dhe rikuperimi, e cila duhet të zhvillohet dhe zbatohet për të siguruar mbrojtjen e të dhënave dhe gatishmërinë për rikuperimin e fatkeqësive.*

d. Testimi dhe Verifikimi:

- *Duhet kryer testim rigoroz, duke përfshirë testimin e performancës, testimin e dështimit dhe testimin e skenarit të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë. Keto detyra duhet të kryhen nga Operatori Ekonomik për të identifikuar dhe korrigjuar pengesat ose dobësitë.*

e. Dokumentacioni dhe Transferimi i Njohurive:

- *Operatori Ekonomik duhet të krijojë dokumentacion të detajuar gjatë gjithë projektit projektit duke ofruar një referencë të vlefshme për sektorin e IT të Autoritetit Kontraktor.*
- *Seancat e trajnimit dhe transferimit të njohurive do të kryhen për të fuqizuar personelin e Autoritetit Kontraktor për të menaxhuar mjedisin e ri të infrastruktures objekt kontrate.*

4.1.2.Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Projekti do të mbulojë këto zona në të cilat Autoriteti Kontraktor “Albpetrol” Sh.A zhvillon veprimtarinë kryesore në fushën e veprimtarisë së hidrokarbure, me vendodhje gjeografike Kuçovë, Patos, Cakran-Mollaj, Gorisht- Kocul, Amonicë-Gorisht dhe Karbunarë.

4.1.3.Grupet e synuara

Ky projekt synon grupet e poshtë-përmendura:

- Autoriteti Kontraktor;
- Qendra e Prodhimit të Naftës (QPN) Kuçovë, Patos, Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, Amonicë-Gorisht dhe Karbunarë;

4.1.4.Siguria e sistemit

Sistemi duhet të jetë i qëndrueshëm, i besueshëm dhe të ofrojë në çdo kohë kontroll të integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit për të garantuar sigurinë nga ndërhyrjet e pautorizuara. Sistemi duhet të përdorë mekanizma autentifikimi moderne dhe të sigurt.

Sistemi duhet të ofrojë profile dhe role me të drejta (*lexim, shkrim, kërkim, printim, eksportim etj.*) dhe në të dhënat që mund të aksesojnë sipas profileve. Me specifikisht sistemi duhet të mundësojë:

Sistemi duhet të ofrojë këto nivele të përdoruesve:

- Administratori - Niveli më i lartë i aksesit i cili është në përdorim vetëm nga specialisti i IT, ku menaxhon përdoruesit e tjerë, nxjerr raporte auditimi mbi aktivitetin e përdoruesve në sistem.
- Drejtues – Ky nivel aksesit do të lejojë monitorimin e të dhënave të vendburimeve në kohe reale si dhe gjenerimin e raporteve të ndryshme dhe eksportin e të dhënave.
- Supervisor - Ky nivel aksesit do të lejojë monitorimin e vendburimeve si dhe gjenerimin e raporteve të ndryshme dhe eksportin e të dhënave në nivel sektori ose qëndre prodhimi.
- Monitorues - Ky nivel aksesit do të lejojë monitorimin e pusëve dhe depozitave si dhe gjenerimin e raporteve të ndryshme dhe eksportin e të dhënave në nivel grupi.

Pajisjet do të instalohen në vendburime dhe në qendrën e të dhënave të Autoritetit Kontraktor dhe duhet të respektojnë rregulloret në fuqi. Të gjitha kërkesat duhet të përmbushin kushtet dhe kërkesat e sigurisë, duke zbatuar gjithashtu rregulloren e Sigurisë së Informacionit.

Niveli i sigurisë sipas klasave të disponueshmërisë, integritetit dhe konfidencialitetit duhet të jetë L-D3I3K2

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
☐ D0	☐ I0	☐ K0	
☐ D1	☐ I1	☐ K1	☐ U
☐ D2	☐ I2	☒ K2	☐ M
☒ D3	☒ I3		☒ L

Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.

Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmëria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.

Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmëria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

Për të arritur nivelin e mësipërm të sigurisë, sistemi duhet të ketë këto specifikime të sigurisë:

Sistem autentifikimi dhe autorizimi

- Qasja në platformën inteligjente si dhe komponentët e tjera të kësaj zgjidhje duhet të sigurohet vetëm për personat me kredenciale. Kjo duhet të sigurohet nëpërmjet një sistemi identifikimi ku përdoruesit duhet të vendosin emrin dhe fjalëkalimin për të patur qasje në platformën smart of komponentët e zgjidhjes.
- Sistemi i autorizimit do mundësojë personat e identifikuar në sistem, të marrin rolin përkatës dhe të kenë akses në funksionalitete dhe të dhëna sipas këtij roli.

Sistem enkriptimi

- Enkriptim i të dhënave në trasmetim – Sistemi duhet të sigurojë që të dhënat janë të enkriptuara në çdo fazë trasmetimi, midis komponenteve si dhe nga përdoruesi fundor deri në databazë.
- Sigurimi i password-eve – Sistemi duhet të sigurojë që fjalëkalimet nuk ruhen në formë të pa-enkriptuar gjatë trasmetimit dhe në bazën e të dhënave

Sistemi i logeve

- Platforma duhet të mundësojë administratorët të identifikojnë veprimet e ndryshme që janë kryer në sistem nëpërmjet logeve. Loget duhet të kenë këtë set minimal të dhënash:
 - Koha e veprimit
 - Përdoruesi
 - Veprimi

Sistemi duhet të mundësojë log-e në databazë në mënyrë që të identifikojë çdo modifikim të dhënash që mund të bëhen jashtë platformës.

4.2. Detyrat specifike

Projekti, do të nënshtrohet 5 (pesë) fazave që paraqiten si mëposhtë:

Faza I: Analiza

Në këtë fazë, (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”) do të bëhen këto detyra:

- Analiza e kërkesave funksionale të ngritjes së infrastrukturës (*në bashkëpunim me punonjësit e Autoritetit Kontraktor*);
- Rishikimi dhe konfirmimi i kërkesave të raportimit;
- Studimi i zonave dhe analiza e Qendrat e Prodimit të Naftës (QPN), ku do të instalohet sistemi inteligjent;
- Përcaktimi i përdoruesve të sistemit dhe rolet përkatëse;
- Përgatitja e dokumentacionit dhe skemave përfundimtare të zgjidhjes;
- Përgatitja e planit të detajuar të punës;

Faza II: Implementimi

Në këtë fazë, ("Kontraktori") ose ("Furnizuesi") do të zhvilloj këto detyra:

- Instalimin dhe konfigurimin i serverit të rrjetit;
- Instalimin dhe konfigurimin e sensorëve të vëllimit për matjen e nivelit të fluidit në depot e përzgjedhura;
- Instalimin dhe konfigurimin e sensorëve të energjisë;
- Instalimin dhe konfigurimin e rrjetit LoRaWAN, përfshirë antenat;
- Instalimi dhe konfigurimi i platformës inteligjente (smart) për monitorimin e Qendrat e Prodhimit të Naftës (QPN);
- Konfigurimi i kontrollit të aksesit bazuar në role dhe implementimi i politikave të sigurisë;

Faza III: Testimi dhe Trajnimi

Në këtë fazë, ("Kontraktori") ose ("Furnizuesi") do të testoj funksionalitetin e infrastrukturës, për qëndrueshmëri, efikasitet, performancë, debug, etj.

- Testimi i infrastrukturës së implementuar dhe përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për konfigurimet dhe menaxhimin e sistemit;
- Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre (nëse ka);
- Trajnimi i stafit për përdorimin e platformës inteligjente.

Faza IV: Marrja në dorëzim e sistemit

Pasi të gjithë funksionalitetet e infrastrukturës të jenë testuar dhe audituar nga Operatori ekonomik, do të bëhet marrja në dorëzim e sistemit. Në marrjen në dorëzim do të përfshihen:

- Infrastruktura dhe të gjithë komponentet e tjerë hardware dhe software;
- Dokumentimi i konfigurimeve përkatëse.

FAZA V: Mirëmbajtja

Mirëmbajtja e platformës inteligjente do të jetë për një periudhë 2 vjeçare.

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Platforma Inteligjente do të instalohet në qendrën e të dhënave (Datacenter-in) e Autoritetit Kontraktor.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës ose data e përcaktuar në kontratë dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 6 muaj nisur nga kjo datë dhe 2 vjet mirëmbajtja pas përfundimit të implementimit të sistemit.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi/Operatori Ekonomik do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën e ofertës, në origjinal dhe në 2 (dy) kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumit 10 (pesëmbëdhjetë) faqesh duhet të prodhohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar

- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të përbehet prej 15 faqesh (*teksti kryesor, duke përjashtuar anekset*). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se dy javë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, me inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit final është 10 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme për të mbështetur një vendim të informuar mbi Sistemin. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Gjithashtu, Kontraktuesi/Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë dhe raporte, si për shembull:

- 1- Raport Instalimi.
- 2- Raport i arkitekturës HW, SW i sistemit.
- 3- Inventari (HW, SW, etj.)

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet grupit të punës të Autoritetit Kontraktor të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Për të siguruar ndërveprim efikas dhe të sigurt me sistemet ekzistuese apo të ardhshme të Autoritetit Kontraktor, si 'Active Directory' për menaxhimin e përdoruesve, platforma duhet të përdorë API-të (Application Programming Interfaces). Kjo qasje me API-të siguron një platformë të integruar dhe të zgjerueshme, duke mundësuar ndërveprimin efikas midis sistemit të ri dhe infrastrukturës ekzistuese në Albpetrol, veçanërisht për menaxhimin e përdoruesve përmes Active Directory.

Aspektet kryesore teknike të mënyrës së ndërveprimit:

- Platforma Inteligjente duhet të ekspozojë të dhëna përmes API-ve RESTful, duke ofruar fleksibilitet dhe shkallëzueshmëri për ndërveprim me aplikacionet e tjera.
- API-të ofrojnë funksionalitet të plotë për të ndërvepruar me Active Directory, duke menaxhuar aksesin dhe autentifikimin e përdoruesve në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me politikën e institucionit për menaxhimin e identiteteve dhe autorizimeve.
- Të gjitha ndërveprimet përmes API-ve duhet të jenë të enkriptuara, duke përdorur TLS (*Transport Layer Security*) për të mbrojtur të dhënat gjatë transmetimit dhe për të siguruar që vetëm përdoruesit e autorizuar kanë akses në sistem.

8. GARANCIA

Të gjitha pajisjet duhet të kenë një garanci 12-mujore, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të procesverbalit të marrjes në dorëzim.

9. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes të infrastrukturës do të jetë për një periudhë 2 vjeçare, në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr.710, datë 21 gusht 2013, "Për Krijimin dhe Funksionimin e

Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

9.1. Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kontraktuesi/Operatori Ekonomik duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në tre muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-et dhe hardware-et. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.
- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/perfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve apo hardware të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të sistemit.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.

(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Autoritetit Kontraktor/Perfituesit brenda intervalit kohor prej 4 (katër) orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t’i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Operatori ekonomik duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin paraprak për çdo ndërhyrje.

9.2. Kategoria e incidenteve

Kategoria A(Kritik/i Lartë)	Kategoria B (I Mesëm)	Kategori C (I Ulët)
-----------------------------	-----------------------	---------------------

Rrezikimi i aktivitetit ekonomik dhe detyrime financiare		
Mos funksionimi i funksionaliteteve që do të shtohen krijon detyrime financiare të mëdha për përdoruesit ose rrezikon shumë aktivitetin ekonomik të përdoruesve	Mos funksionimi i funksionaliteteve që do të shtohen krijon detyrime financiare të konsiderushme për përdoruesit ose rrezikon konsiderueshëm aktivitetin ekonomik të përdoruesve	Mos funksionimi i funksionaliteteve që do të shtohen krijon detyrime financiare minimale për përdoruesit ose rrezikon në mënyrë minimal aktivitetin ekonomik të përdoruesve
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesë të punës së tyre	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Zgjidhje alternative e përkohshme[Kjo ka peshën më të madhe të karakteristikave të Seriozitetit 1 dhe 2.		
Nuk ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	Ka pjesërisht një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
10 min. për të kthyer përgjigje Në vend brenda 4 ore.	30 min.për të kthyer përgjigje Në vend brenda 8 orëve	60 min.për të kthyer përgjigje Në vend brenda 24 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

10.PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
-----	----------	--------	-------	-------	-------

					(Lekë pa TVSH)
1.	Sensorë Inteligent të vëllimit (Furnzim, Instalim dhe Konfigurim).	copë	150		
2.	Pajisje inteligjente e menaxhimit të energjisë (Furnzim, Instalim dhe Konfigurim).	copë	150		
3.	Antenat LoRaWAN (Furnzim, Instalim)	copë	10		
4.	Konfigurimi i Platformes Inteligjente Smart	copë	1		
5.	Licensat për Platformen Inteligjente/Smart (për 300 sensor)	muaj	24		
6.	Konfigurimi i Platformes se Serverit të rrjetit	copë	1		
7.	Licensat për Platforma e Serverit të rrjetit (për 10 antena)	muaj	24		
8.	Trajnim i Përdoruesve të platformës.	muaj	1		
9.	Mirëmbajtje	Vite	2		
TOTALI PA TVSH (LEKË)					

11.AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	...	M31
1.	Faza Përgatitore për dokumentimin e analizës dhe dizenjimin e infrastrukturës.	x								
2.	Lëvrimi i pajisjeve hardware.		x	x						
3.	Faza e Instalimit dhe konfigurimit të Platforma e Serverit të rrjetit.		x	x						

4.	Faza Instalimit dhe konfigurimit të sensorëve, pajisjeve inteligjente e menaxhimit të energjisë dhe Antenat LoRaWAN.			x	x	x	x			
5.	Faza e Instalimit dhe Konfigurimit të Platformave inteligjente.				x	x	x			
6.	Trajnimi i përdoruesve.					x	x			
7.	Marrja në dorëzim.						x			
8.	Mirëmbajtje.							x	x	x

12.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT


Të gjitha të drejtat mbi dokumentacionin teknik (mënyrën e konfigurimi të sistemit, skica, etj.) do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues. Infrastruktura (*pajisjet hardware dhe software-i*) do të dorëzohen të shoqëruar me setin e dokumentacionit teknik që përfshin dokumentacionin teknik të komponentëve të ndryshme në veçanti dhe dokumentin teknik në tërësi.

13.KËRKESAT FUNKSIONALE

Për të siguruar automatizimin, infrastruktura inteligjente për komunikimin dhe transmetimin e të dhënave në distanca të gjata, duke përdorur sensorë me konsum të ulët energjie (LPWAN), duhet të automatizojë procesin e raportimit për dy komponentë kryesorë:

- **Niveli i fluidit në depo dhe dekantim:** Sistemi duhet të ofrojë në mënyrë të rregullt informacion të përditësuar mbi sasinë e fluidit që ndodhet në depo dhe në procesin e dekantimit.
- **Orët e punës së puseve:** Zgjidhja duhet të sigurojë raportime të rregullta dhe të detajuara për orët e punës së puseve, duke treguar në mënyrë të saktë kohën e operacioneve për secilin pus.

Me poshtë do të gjeni një paraqitje vizuale të arkitekturës së zgjidhjes:



13.1. Funksionalitete dhe Blokskema

Në këtë seksion do të përshkruajmë komponentët, modulet dhe funksionalitetet përkatëse që platforma duhet të përmbajë. Infrastruktura do të përbëhet nga këto komponentë dhe modulet e tyre përkatëse:

- Platforma Inteligjente (Aplikacioni)
- Serveri i Rrjetit (Network Server)
- Antenat LoRa
- Sensorët Inteligjent

Për secilin komponent dhe modul, janë përcaktuar funksionalitetet siç vijon:

Platforma Inteligjente (Aplikacioni)	
Funksionalitetet	Përshkrimi
Hyrja në sistem	Sistemi duhet të lejojë vetëm përdoruesit e autorizuar të aksesojnë sistemin nëpërmjet emrit dhe fjalëkalimit të personalizuar.
Manaxhimi i përdoruesve	Sistemi duhet të mundësojë administratorët të manaxhojnë përdoruesit e sistemit përfshirë këtu (<i>Shtim, Përditësim, Fshirje</i>).
Manaxhimi i të drejtave	Sistemi duhet të mundësojë administratorin të caktojë përdoruesve të drejtat ne nivel grupi. Këto të drejta duhet te përfshijnë detajime ne nivel pajisje fundore, funksioni si dhe aktivitete si qasjen ne module, exportin e të dhënave, gjenerimin e raporteve, etj.).
Log-et	Sistemi duhet ti mundësojë administratorit një ndërfaqe për të

	parë të gjitha loget e sistemit, pa lejuar modifikim e tyre. Sistemi duhet të lejojë exportin e log-eve në format tabelar për nevoja auditimi.
Menaxhimi i ndërlidhjes (downlink Managment)	Platforma duhet të lejojë përditësimin dhe konfigurimin në distancë të pajisjeve përmes teknologjisë OTA (Over the Air), duke përfshirë: • Përditësimin e firmuerit të pajisjeve; • Përcaktimin e frekuencave për mbledhjen e të dhënave; • Aktivizimin e një kampionimi të menjëhershëm sipas nevojës; • Rregullimin e shpeshtësisë së transmetimit të të dhënave.
Përpunimi i të dhënave	Aplikacioni duhet të grumbullojë të dhëna nga pajisjet dhe t'i përpunojë ato në përputhje me kërkesat specifike të Autoritetit Kontraktor.
Vizualizimi	Platforma duhet të ofrojë mundësinë për të vizualizuar statusin e pajisjeve dhe të lejojë modifikimin ose përditësimin e konfigurimeve të tyre.
Alarmet dhe njoftimet	Platforma duhet të lejojë krijimin e rregullave për monitorimin e pajisjeve dhe sistemeve të ndryshme, duke u bazuar në të dhënat që ato raportojnë. Sistemi i alarmeve duhet të ofrojë mundësinë e konfigurimit të një ose më shumë parametrave, të cilët mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në: • alarmet e komunikimit; • alarmet për parametrat e sistemit; • alarmet për afatet kohore të skaduara; • alarmet e kontrollit. Gjithashtu, platforma duhet të mundësojë dërgimin e këtyre alarmeve dhe njoftimeve përmes SMS dhe/ose E-mal drejt përdoruesve të caktuar.
Raportet dhe eksporti i të dhënave	Platforma duhet të ofrojë raporte të paracaktuara dhe mundësi për analizë të personalizuar të të dhënave, duke përfshirë si të dhënat në kohë reale, ashtu edhe ato historike. Ajo duhet të lejojë aplikimin e mekanizmave për analiza të avancuara të të dhënave, duke përfshirë përdorimin e formulave të ndryshme, si për shembull llogaritjen e vëllimit për çdo pus specifik. Gjithashtu, platforma duhet të mbështesë eksportin e të dhënave dhe sinjaleve nga pajisjet në formate të ndryshme, si CSV, Word, ose PDF.
Paneli i Administrimit	Platforma duhet të sigurojë një panel administrativ që i mundëson Autoritetit Kontraktues të kryejë veprime si menaxhimi i përdoruesve, kontrolli i të drejtave të aksesit dhe administrimi i pajisjeve fundore, përfshirë sensorët.

Siguria	Platforma duhet të sigurojë të dhënat gjatë transmetimit duke përdorur enkriptimin përmes protokollit HTTPS.
---------	--

Serveri i Rrjetit (Network Server)	
Funksionalitetet	Përshkrimi
Menaxhimi i rrjetit (antenave)	Të mundësohet provizionimi, konfigurimi, administrimi dhe mirëmbajtja e antenave. Të ofrohet një katalog i plotë i antenave gati për përdorim, duke mbështetur modelet nga të gjithë prodhuesit kryesorë. Të ofrohen opsione të ndryshme, përfshirë etiketimin (tagging) e antenave, filtrimin e listës dhe lokalizimin e antenave në hartë. Të mundësohet përdorimi i antenave të palëvizshme dhe atyre të lëvizshme. Të ofrohen grafikë për monitorimin e indikatorëve të radio frekuencave dhe performancës së sistemit (çdo orë, çdo ditë). Të ofrohen alarme për ngjarje të ndryshme në nivel antene, si keqfunksionime, gabime të lidhjes, mosfunksionim të GPS, përdorim i lartë i burimeve CPU/RAM/Disk, saturimi i kapacitetit të radios, aktivitet i ulët në uplink, dhe sulme të tipit replay. Antenat LoRa duhet të mundësojnë menaxhimin nw distancë. - Menaxhim i sigurt nga distanca përmes një ndërfaqeje grafike. - Përditësim i platformës së antenës në mënyrë të largët. - Mundësi kryerjeje të operacioneve nga distanca, si backup, rikthim, rifillim i antenës dhe aktivizim i gjurmimit lokal (trace).
Menaxhimi i pajisjeve fundore	- Të ofrojë provizionim, konfigurim, administrim dhe mirëmbajtje të sensorëve fundorë. - Të sigurojë një katalog të gatshëm me profile të para-konfiguruar për pajisjet fundore, duke përfshirë profile të përgjithshme dhe specifike sipas prodhuesit. - Të mundësojë një katalog të gatshëm të driverëve për të lejuar enkodimin/dekodimin e ngarkesës së aplikacioneve në uplink/downlink. - Të ofrojë opsione të ndryshme, duke përfshirë etiketimin (tagging) e pajisjeve, filtrimin e listës, lokalizimin e pajisjeve në hartë dhe dërgimin e komandave downlink nga ndërfaqja në çdo pajisje. - Të lejojë provizionim me pak ndërveprim (low touch) të pajisjeve duke përdorur kode QR. - Të mundësojë provizionim në masë (bulk) duke importuar

	listën e pajisjeve. • Të lejojë aktivizimin në nivel pajisjeje të funksionaliteteve shtesë si Roaming dhe Gjeolokacioni në rrjet (network geolocation). • Të përmbajë funksione të aktivizimit të pajisjeve si OTAA (Over The Air Activation) dhe ABP (Activation By Personalization). • - Të ofrojë menaxhim multicast: konfigurimin dhe mbikëqyrjen e grupeve multicast si për modet e klasës B ashtu edhe të klasës C.
Menaxhimi i aplikacioneve inteligjente	Provizionim dhe konfigurim i lidhjes me aplikacionet smart. Të mbështesë konektorë të përgjithshëm si: - HTTPS - MQTT - AMQP Aktivizimi dhe çaktivizimi i këtyre konektorëve do të bëhet nëpërmjet ndërfaqes grafike. Sistemi duhet të monitorojë indikatorët e mëposhtëm: - Detektimin e serverëve të aplikacioneve të mbingarkuar - Monitorimin e statusit në kohë reale. - Monitorim ditor dhe me orë të trafikut.
Menaxhimi i përdoruesve	Të ofrojë role të ndryshme, duke përfshirë: - Administrator - Menaxher të pajisjeve fundore dhe të lidhjes - Menaxher të antenave - Shikues (vetëm për shikim)
Raportet	Platforma duhet të ofrojë mundësinë e gjenerimit të raporteve të ndryshme dhe aksesin në të dhënat historike sipas kërkesës.
Eksporti i të dhënave	Platforma duhet të sigurojë opsionin për eksportimin e të dhënave të raporteve ose të dhënave historike në formate të ndryshme, si CSV, Word dhe PDF.
Të tjera	Të ofrojë mundësinë e integritetit të hartave të ndryshme, si Google Maps dhe OpenStreet Maps.

14.KËRKESAT TEKNIKE

14.1. Specifikime Teknike të Serveri të Rrjetit (Network Server)

Serveri i rrjetit (Network Server)	
Arkitektura	
Funksionalitetet	Përshkrimi
Arkitekturë me shtresa	Sistemi duhet të ofrojë një arkitekturë shtresore, duke ndarë të

	dhënat, llogjikën e punës dhe shtresën e publikimit në mënyrë që të rritet siguria dhe fleksibiliteti i sistemit Shtresat minimale të sistemit duhet të jenë: ○ Shtresa e të dhënave ○ Shtresa e proceseve të punës ○ Shtresa e prezantimit
Ndërveprimi	Sistemi duhet të ofrojë API të standardizuar në mënyrë që të mundësojë ndërveprimin me sisteme të ndryshme në të ardhmen. API-t duhet të jenë të bazuar në standardet ndërkombëtare.
Baza e të dhënave	Sistemi duhet të ndërtohet bazuar në baza të dhënash relacionale. Kostot e liqensimit duhet të jenë të përfshira në projekt ose platforma me kode burim të hapur.
Sistemi i operimit	Sistemi i operimit të serverit duhet të ketë arkitekturë 64 bit, të ofrojë Mirëmbajtje me Kohë të gjatë (<i>Long Term Support</i>) nga ("Furnizuesi/Operatori Ekonomik"). Sistemi i operimit duhet të mos ketë kosto ekstra për përdorimin e tij dhe mos të ketë kohë mbarimi të liqenses (<i>perpetual licensing model</i>).
Përputhshmëria	Sistemi duhet të aksesohet nga shfletuesit modernë si Google Chrome, Microsoft Edge, Mozilla Firefox etj..
Siguria	Mbrojtja e integritetit të ngarkesës (Payload) Enkriptim gjatë komunikimit radio Infrastruktura PKI e integruar Shkëmbimi i sigurt i raporteve hyrëse/dalëse me serverat e aplikacioneve nëpërmjet protokollit TLS. Autentifikimi i sigurt i përdoruesit fundor Menaxhimi i përdoruesve duke ofruar disa role nga administratorët tek përdoruesit që vetëm shikojnë (read only).

14.2. Specifikime Teknike të Platformës Inteligjente (Smart)

Platforma Inteligjente (Smart)	
Arkitektura	
Funksionalitetet	Përshkrimi
Arkitekturë me shtresa	Sistemi duhet të ofrojë një arkitekturë shtresore, duke ndarë të dhënat, llogjikën e punës dhe shtresën e publikimit në mënyrë që të rritet siguria dhe fleksibiliteti i sistemit Shtresat minimale të sistemit duhet të jenë: ○ Shtresa e të dhënave ○ Shtresa e proceseve të punës ○ Shtresa e prezantimit
Ndërveprimi	Sistemi duhet të ofrojë API të standardizuar në mënyrë që të mundësojë ndërveprimin me sisteme të ndryshme në të

	ardhmen. API-t duhet të jenë të bazuar në standardet ndërkombëtare.
Baza e të dhënave	Sistemi duhet të ndërtohet bazuar në baza të dhënash relacionale. Kostot e liqensimit duhet të jenë të përfshira në projekt ose platforma me kode burim të hapur.
Sistemi i operimit	Sistemi i operimit të serverit duhet të ketë arkitekturë 64 bit, të ofrojë Mirëmbajtje me Kohë të gjatë (<i>Long Term Support</i>) nga ("Furnizuesi"). Sistemi i operimit duhet të mos ketë kosto ekstra për përdorimin e tij dhe mos të ketë kohë mbarimi të liqenses (perpetual licensing model)
Përputhshmëria	Sistemi duhet të aksesohet nga shfletuesit modernë si Google Chrome, Microsoft Edge, Mozilla Firefox etj.

14.3. Specifikime Teknike të Antenave (Gateway)

Antenat (Gateway)	
Lloji i antenës	Antenë e jashtme
Specifikimet e komunikimi	
Frekuencat	EU 862~870 MHz
Numri I kanaleve	Deri ne 16 kanale
Protokolli	LoRAWAN
Versioni	LoRaWAN 1.0.2
Modulimi	Bazuar në LoRaWAN
Nderfaqet	Të paktën: • 1 (një) port LAN; • 2 (dy) ndërfaqe për antena LoRa; • 1 (një) ndërfaqe për lidhjen e një antene GPS; • 1 (një) ndërfaqe për antenën 3G/4G.
Mbulimi	Të paktën 15km rreze mbulimi.
RF Transceiver	SX1301 me SX1257 ose SX1255
Transmit RF Power	0.5W (maksimumi 27 dBm)
Sensitiviteti I marresit	Deri në -142 dBm
Specifikimet fizik	
Temperatura e operimit	-40°C ~ 60°C
Temperatura e ruajtjes	-40°C ~ 60°C
Voltazhi	55VDC/0.6A nëpërmjet adaptorit PoE
Përmasat	Maksimumi: • Gjatësia: 250mm

	- Gjerësia: 220 mm - Lartësia : 80 mm
Pesha	Jo me shumë se 2.5 kg
Niveli i mbrojtjes	IP67
Specifikime të tjera	
Encriptimi i komunikimit	AES 128
Paisje fundore	Të lejoj lidhjen e minimumi 10000 paisjeve

4.4. Specifikime Teknike të Sensorëve Inteligjent të Vëllimit

Sensore Inteligjent të vëllimit	
Specifikimet e sensorit	
Diapazoni	10m
Saktesia	±2 mm
Distanca minimale e matjes	20cm
Presioni	-1 deri ne 3 bar
Frekuenca	90GHz
Kendi i rezes	8 gradë
Temperaturat e pranuar	-20 deri ne +85 °C
Energjia	
Ushqimi	- Bateri litiumi e integruar, e zëvendësueshme. - Mundesi për burim energjie të jashtme.
Voltazhi	3.6 V
Jetegjatesia e baterisë	- Të paktën 100000 lexime - Të paktën 20000 dergime
Specifikimet e fizike	
Materjali	Veshja: POM (Polyoxymethylene) Sensori: PVDF (Polyvinylidene fluoride), PA6 dhe Fibër Xhami
Pesha	Jo më shumë se 1000g
Niveli i mbrojtjes	IP68 me mbrotje nga rezet ultravjollcë
Specifikimet e komunikimit	
Protokolli	LoRaWAN
Versioni	1.0.2revB, Class A
Frekuencat	EU868
Mënyra e aktivizimit	Aktivizimi përmes valëve (OTA) i paracaktuar me opsionin për të mundësuar edhe aktivizimin përmes personalizimit

	(ABP).
Mënyra e mbledhjes se informacionit	Mostra periodike (e paracaktuar) me mundësinë për t'u konfiguruar në bazë të ngjarjeve (drejtuar nga ngjarje).
Shpeshtësia e mbledhjes se informacionit	E konfigurueshme, me frekuencë/shpeshtësi duke filluar nga një herë çdo 10 minuta.
Lloji i transmetimit	E programuar për të transmetuar mostrat. Në rastet e ngjarjeve.
Konfigurimi i parametrave	Aktivizimi përmes valëve (OTA) në rrjetin LoRaWAN realizohet duke përdorur lidhjen wireless kur je në afërsi lokale.
Përditësimi i fireware-it	Përmes lidhjes wireless kur je në vend ose përmes përditësimit të të dhënave mbi valë (OTA) në rrjetin LoRaWAN.
Specifikime te tjera	
Integrimi	Integrimi me rrjetet kryesore, duke përfshirë Actility, Cisco, Digita, Everynet, Helium, Kerlink, KPN, Lorient, machine-Q, Objenious, Orange, Orbiwise, Proximus, Senet, Sens, Swisscom, TATA, dhe TTL.
Vizualizimi dhe menaxhimi i të dhënave	Integrimi me platformat kryesore IoT mund të realizohet drejtpërdrejt ose përmes API-ve.

4.5. Specifikime Teknike të Pajisjes inteligjente të menaxhimit të energjisë

Pajisja inteligjente e menaxhimit te energjise	
Komunikimi	
Protokolli	LoRaWAN
Frekuencat	EU868
Mënyra e aktivizimit	Aktivizimi përmes valëve (OTA) është paracaktuar, por gjithashtu të mundësohet edhe aktivizimi përmes personalizimit (ABP).
Përditësimi i fireware-it	Përditësimi nëpërmjet valëve (OTA) në rrjetin LoRaWAN
Parametrat e pajisjes	
Fuqia e sinjalit dalës (TX Power)	LoRa EU868: deri në +14 [dBm] Bluetooth Low Energy (BLE): nga -20 deri në +6 [dBm]
Furnizimi me energji	6 - 30 V DC 5 - 21 V AC
Konsumi i energjisë	Konsumi mesatar: 18 mA DC(12VDC) Konsumi maksimal: 250 mA DC (12 V DC)
Pesha	Jo më shumë se 200 gr.
Specifikimet e fizike	
Rezistenca ndaj zjarrit	UL94-VO
Niveli i mbrojtjes	Të paktën IP20

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Implementimi i Smart Solution LoRaWAN ne infrastrukturen naftexjhere te Albpetrol sh.a. per periudhe 2 vjecare” sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë pa TVSH)
1.	Sensorë Inteligent të vëllimit (Furnzim, Instalim dhe Konfigurim).	copë	150		
2.	Pajisje inteligjente e menaxhimit të energjisë (Furnzim, Instalim dhe Konfigurim).	copë	150		
3.	Antenat LoRaWAN (Furnzim, Instalim)	copë	10		
4.	Konfigurimi i Platformes Inteligjente Smart	copë	1		
5.	Licensat për Platformen Inteligjente/Smart (për 300 sensor)	muaj	24		
6.	Konfigurimi i Platformes se Serverit te rrjetit	copë	1		
7.	Licensat për Platforma e Serverit të rrjetit (për 10 anetena)	muaj	24		
8.	Trajnim i Përdoruesve të platformës.	muaj	1		
9.	Mirëmbajtje	Vite	2		

Afatet e ekzekutimit:

“Implementimi i Smart Solution LoRaWAN ne infrastrukturen naftenxjere se te Albpetrol sh.a. per periudhe 2 vjecare”

AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	...	M30
1.	Faza Përgatitore për dokumentimin e analizës dhe dizënjimin e infrastrukturës.	x								
2.	Lëvrimi i pajisjeve hardware.		x	x						
3.	Faza e Instalimit dhe konfigurimit të Platforma e Serverit të rrjetit.		x	x						
4.	Faza Instalimit dhe konfigurimit të sensorëve, pajisjeve inteligjente e menaxhimit të energjisë dhe Antenat LoRaWAN.			x	x	x	x			
5.	Faza e Instalimit dhe Konfigurimit të Platformave inteligjente.				x	x	x			
6.	Trajnimi i përdoruesve.					x	x			
7.	Marrja në dorëzim.						x			
8.	Mirëmbajtje.							x	x	x

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kritereve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2.2.2. Kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për pervojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

OSE

Në rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për pajisjet: Antenat (Gateway), sensorët inteligjentë të vëllimit dhe sensorët inteligjent të monitorimit të energjisë. Ky autorizim duhet të përfshijë kontaktet e plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, si: numrin e telefonit, adresën e e-mailit dhe faqen e internetit. Në rast se autorizimi është lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të sigurohet vërtetimi i marrëdhënies midis tij dhe prodhuesit. Po ashtu, në deklaratën e lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, duhet të konfirmohet se pajisjet e ofruara do të jenë të pajisura me sistemin origjinal të prodhuesit (OEM).

- 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike në gjuhën shqipe ose angleze për produktet objekt prokurimi (antenat, sensorët inteligjentë të vëllimit dhe sensorët inteligjent të monitorimit të energjisë), ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim për parametrat teknikë të produktit (*shih specifikimet teknike*) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë sistemi/pajisja që ofrohen dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për to.

- 2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- a) Standardin ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- b) Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- c) Standardin ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- d) Standardin ISO 45001:2018 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ose ekuivalente, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme sipas standardit ISO.

- 2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit dhe vendosjes së pajisjeve hardware dhe software objekt-kontratë, duhet të disponojë minimalisht 12 (dymbëdhjetë)

-
- punonjës, të diplomuar në një nga porfilet e IT si, të cilët në mënyrë të kombinuar, të plotësojnë kërkesat për certifikime profesionale, si më poshtë:
- 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional për projektimin e rrjetave me valë
 - 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivel experti ne rrjeta dhe siguri
 - 4 (katër) punonjës të certifikuar në nivel bazë/profesional për rrjete LoRaWAN, Cisco ose ekuivalente.
 - 2 (dy) punonjës të certifikuar në menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.
 - 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional, për menaxhimin e projekteve.

Shënim: Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime.

Operatori Ekonomik i klasifikuar i pari, për të dëshmuar përmbushjen e kriterëve sa mësipër, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentet në origjinal ose kopje të noterizuara për punonjësit e mësipërm, dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diplomë e arsimit të lartë, duke përfshirë të gjitha degët e informatikës, shkencave kompjuterike, dhe teknologjisë së informacionit.
- Certifikatat/Transkriptet përkatëse të vlefshme të lëshuara nga organizma të akredituara nga Republika e Shqipërisë ose nga vendi i origjinës, për secilin specialist të kualifikuar.
- Listepagesat e shoqërisë për të pakten 3 (tre) muajt e fundit në të cilat stafi i siperpermendur duhet të figurojë.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku konfirmon se do të kryejë konfigurimin, implementimin dhe vënien në funksion të sistemeve dhe pajisjeve, si dhe të marr përsipër trajnimin e përdoruesve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005). Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit. Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. - Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

